



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCËVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Nr. Org. Org. Jedinica Org. Unit	1409
Nr. i Fajevë Be. Stranica No. Pages	1/28
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	45/22
Data : Datum :	24.08.2022
Prishtinë / a	

Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, rada i
transfera – Ministry of Finance, Labor and Transfers
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE/ CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM

TITULLI I KONTRATËS:

FURNIZIM ME KARBURANTE – NIVELI QENDROR - FURNIZIM ME
KARBURANTE PËR NEVOJAT E FSK-SË

NUMRI I PROKURIMIT: UA/2016-22-7727-1-1-1

NUMRI I BRENDSHËM I PROKURIMI: AQP-22-005-R-111

NUMRI I KONTRATËS: UA/2016-22-7727-1-1-1/C257

DRAFT KONTRATA PUBLIKE KORNIZË, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

"HIB PETROL"SH.P.K., Adresa:: Magjistrallja Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol, 10000 Cagllavice,
NUI: 810662834 (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për
furnizim me:

**Furnizim me karburante – Niveli Qendror - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së me
numëri brendshëm identifikues: AQP/22/005-R/111**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e karburanteve për nevojat e FSK-së.

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për Autoritetin Kontraktues Ministria e Mbrojtjes/ FSK.

1.2 Nuk nevojitet fletëporosia apo thirrja për furnizim me karburante për vetura, ndërsa për furnizim me karburante për rezervuarët, gjeneratorët apo nxehmjet do të lëshohet fletëporosi nga AK-MM/FSK.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë sasi indikative. Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është i detyruar të përdorë këtë kontratë kornizë sa herë që do të furnizohet me mallëra të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 29.08.2022 dhe përfundon në datën 28.08.2023.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë sipas kushteve të paraqitura në Aneksin 1 Specifikimet teknike të detyrueshme.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jenë pikat e caktuara në kazermat e FSK-së sic është e sqaruar në Aneksin 1 Specifikimet teknike të detyrueshme.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

Ne	Lloji i karburantit	Premiumi për një litër
1	Naftë	0.055€
2	Benzinë	0.055€

Vlera totale e parashikuar e kontratës është **1,625,530.24€** (një milion e gjashtëqindnjëzetepesë mijë e pesëqindetridhjetë euro e njëzet e katër cent) sasia totale indikative e kontratës është 1,071,600 litra. Çmimi për Premium është 0.055€/litër apo 58,938€ për totalin indikativ të litrave. Devijimi i lejuar është +/-30% i sasisë së litrave (1,071,600) apo i çmimit total indikativ të Premiumit (58,938€).

4.2 Çmimi i premiumit është fiks dhe nuk ndryshon ndërsa çmimi për litër të karburantit është variabil. Kalkulimi i çmimit gjatë realizimit të kontratës bëhet duke u bazuar në çmimin mesatar mujor të berzës së Plattit CIF Med (Genova/Lavera), kursit mesatar mujor të Bankës Qendrore Evropiane dhe elementeve tjera fikse dhe variabile që janë pasqyruar në Aneksin 10 - Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve që është pjese e kësaj kontrate.

4.3 Agjencia Qendrore e Prokurimit ka qasje në berzë dhe bënë kalkulimin e çmimit në baza mujore duke u bazuar në tabelën e formimit të çmimeve. Autoriteti Kontraktues, Agjencia Qendrore e Prokurimit, më së largu deri me datën pesë (5) të muajt vijues dërgon të Furnizuesi kalkulimin e çmimeve për muajin paraprak dhe publikon çmimet në ueb faqe. Obligohet Furnizuesi që më së largu deri me datën dhjetë (10) të muajt vijues të dërgojë të gjitha faturat për shpenzimet e karburanteve për muajin paraprak tek MM-FSK. Agjencia Qendrore e Prokurimit. Këtë vendim të formimit të çmimeve të publikuar në ueb faqen e AQP-së kanë të drejtë ta shfrytëzoj vetëm Autoriteti kontraktues MM-FSK.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Aneksi nr.1 Specifikimet Teknike;
- (c) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (d) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (e) Tenderi i Furnizuesit
- (f) Aneksi nr. 9 - Tabela e formimit të çmimeve

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Mehmet Rama	Emri:	Behxhet Rrukiqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.08.2022	Data:	24.08.2022
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	KORAB SEJDIU
Pozita:	Menaxher i Kontraktimit
Nënshkrimi:	
Data:	24.08.2022
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikuajt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, siguri i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të

kontrates, Furnizuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktun pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e përshtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkthazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruar plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Tatimi

10.1 Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

10.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

10.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të pranimit të mallrave.

10.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Furnizuesi.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikut të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porositi furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosisë se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosisë se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimi në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimi.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar.

nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimi në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimi;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimi të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtësore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtësore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrë e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17 Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimi me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe

testim;

b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testeve;

c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuar si duhet të rezultateve të testit të Autoriteti kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohej se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 18 Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse

është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënimet dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimi derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimi të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimi, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhrë, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbrësë nga paratë që do të paguhet ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimi, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimi të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimi të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimi ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimi të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të

pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimit përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbajtësore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkaktën kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Nen-kontraktimi	4	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Dhënia e dokumenteve	5	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Autoritet Kontraktues – MM/FSK, brenda 5 (pesë) ditëve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që të dorëzojë tek Furnizuesi një listë të rezervuarëve që do të menaxhohen nga Furnizuesi. Furnizuesi duhet të dorëzojë një listë të punëtoreve që do të shërbejnë për ekzekutimin e kësaj kontrate, kjo listë mund të ndryshohet me kërkesën e Furnizuesit dhe pajtimin e AK apo me kërkesën e AK-së. Autoritet Kontraktues –MM/FSK, brenda 5(pesë) ditëve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që të hartoj Planin e Menaxhimit të Kontratës Autoritet Kontraktues –MM/FSK do të emërojë një/disa përfaqësues si pikë koordinimi ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Furnizuesit i cili do të jetë në dispozicion çdoherë që kërkohet dhe do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.
Ndihma lidhur me rregulloret vendore	6	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.1	Kërkohet nga Furnizuesi që të marrë nënshkrimet e pranimit të karburanteve / të lëshojë kuponin e karburantit dhe/apo fletën e të dhënave nga i gjithë personeli i autorizuar të cilët marrin karburantet për përdorim në automjete, gjeneratorë, nxehmje ,etj. Nevojiten të dhënat në vijim: • Data dhe koha e lëshimit; • Emri i entitetit, departamentit, seksionit, njësisë pranuese; • Emri - mbiemri dhe numri i identifikimit të individit që pranon furnizimin; • Lloji i karburantit të marr; • Detajet e automjeteve; • Detajet e gjeneratorit; • Në rastin e karburantit në rezervuar detajet siç është vendndodhja e saktë; • Sasinë (në litra) e karburantit.

			Furnizuesi, ne baza 3 mujore, do te raportoj me shkrim, tek Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me sasitë e karburanteve të shpenzuara me këtë kontratë. Raporti duhet te paraqes: - Sasinë e karburanteve te dorëzuara; - Llojin e karburanteve; Në rastet kur kërkohet nga AQP-ja, Furnizuesi duhet ta plotësojë raportin edhe me të dhënat: - Datën e faturave, numrin e faturave dhe vlerën e faturave; - Datën e pagesës së faturave; Agjencia Qendrore e Prokurimit do te hartoj një model të Raportit dhe do ta dërgoj te Furnizuesi jo me vone se 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës. Obligohet furnizuesi qe ta shfrytëzoj këtë model të Raportit gjatë raportimit. AQP ka te drejt të kërkoj nga kontraktuesi raportime me të shpeshta dhe kjo do të jetë obligim për kontraktuesin. Mos raportimi me kohë pranë AQP-së nga ana e Furnizuesit, e detyron AQP-në që të marrë masa, siç është konfiskimi i garancionit të ekzekutimit dhe lëshuarja e Referencës negative për kontratën e nënshkruar.
Obligimet përgjithshme Furnizuesit	e te	7.2	Autoriteti Kontraktues ne nenin 7.2 i referohet Autoritetit Kontraktues – MM/FSK.
Obligimet përgjithshme Furnizuesit	e te	7.4	Autoriteti Kontraktues ne nenin 7.4 i referohet Agjencisë Qendrore te Prokurimit.
Siguria ekzekutimit	e	8.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 162,553.02€ me validitet deri më 29.09.2023
Periudha ekzekutimit detyrave	e të	12	Ekzekutimi i kontratës do të bëhet sipas kushteve të caktuara në Aneksin 1 Specifikimet teknike të detyrueshme.
Zgjatja e periudhës së ekzekutimit		13	Autoriteti Kontraktues ne nenin i referohet Autoritetit Kontraktues –MM/FSK. zgjatja e periudhës së ekzekutimit lejohet vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK.
Vonesat ekzekutim	ne	14	Autoriteti Kontraktues ne nenin 14 i referohet Autoritetit Kontraktues – MM/FSK.
Suspendimi		15	Autoriteti Kontraktues ne nenin 15 i referohet Autoritetit Kontraktues – MM/FSK
Cilësia furnizimeve	e	16.1	Autoriteti Kontraktues –MM/FSK ka te drejte te refuzojnë çdo dërgesë të karburantit i cili dështon ne përmbushjen e cilësisë te përcaktuara me udhëzimet apo vendimet e organeve kompetente në Republikën e Kosovës, duke njoftuar me shkrim Furnizuesin dhe AQP-në si dhe organet kompetente.
Cilësia furnizimeve	e	16.2	Për furnizimin me karburante Autoritet Kontraktues –MM/FSK nuk lëshon ndonjë pranim të përkohshëm. Pasi që të shkarkohen karburantet në rezervuarë (që menaxhohen nga FSK për rezerva dhe jo rezervarët të cilët do të menaxhohen nga Furnizuesi), gjeneratorë apo ne automjete etj. dhe nënshkruhet fletëpranimi nga një person i autorizuar i Autoritetit Kontraktues malli do të konsiderohet si i pranuar përkohësisht.
Inspektimi testimi	dhe	17.2	Furnizuesi duhet të kryejë inspektimin e kontrollit të cilësisë së produkteve të ofruara dhe do ti dorëzoj ato tek Autoriteti Kontraktues –MM/FSK në përputhje me procedurat, standardet dhe frekuencat e rekomanduara të cilat zakonisht zbatohen në industrinë e naftës.

		Inspektimi dhe testimi do të siç është përcaktuar në Aneksin 1 Specifikimet teknike të detyrueshme.
Pagesat	18	Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues MM-FSK. Pagesa do të bëhet për sasinë e karburanteve ashtu siç është përcaktuar në Aneksin 1 Specifikimet teknike të detyrueshme. Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të çdo muaji, Furnizuesi duhet të dorëzoj një faturë origjinale dhe një kopje për karburantet të cilat janë shpërndarë dhe/ose dorëzuar gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro. Fatura mund të dorëzohet në formë fizike ose/dhe elektronike. Çdo fature duhet të përmbajë të informacionin e nevojshme. Rishikimi i Çmimit: Çmimet e karburanteve do të përditësohet në baza mujore duke marrë parasysh elementet e mëposhtme: Referoju pjesës C, Seksioni II, Lista e Çmimeve dhe Aneksi nr. 9 - Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve. Agjencia Qendrore e Prokurimit ka qasje në berëz dhe bënë kalkulimin e çmimit në baza mujore duke u bazuar në Aneksin nr. 9 Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve. Autoriteti Kontraktues-Agjencia Qendrore e Prokurimit me së largu deri në datën pesë (5) të muajt vijues (përveç rasteve të festave zyrtare që mund të shtyhet një apo dy ditë) dërgon të Furnizuesi kalkulimin e çmimeve për muajin paraprak. Furnizuesi pas publikimit të çmimeve do të përgatit dhe të dorëzojë faturën. Agjencia Qendrore e Prokurimit, vendimin e formimit të çmimeve të karburanteve për çdo muaj do ta publikoj në ueb faqen e AQP-se. Këtë vendim të formimit të çmimeve të publikuar në ueb faqen e AQP-se kanë të drejtë ta shfrytëzojnë vetëm Furnizuesi sipas kushteve të kësaj kontrate dhe Autoriteti Kontraktues – MM/FSK. Nuk lejohet Autoritetet tjera Kontraktues të përdorin Vendimet e formimit të çmimeve të kësaj kontrate.
Dorëzimi	19.3	Rreziku i humbjes apo dëmtimit, të karburantit nga ndonjë shkak do të jetë mbi Furnizuesin dhe do të përballohet nga Furnizuesi deri në kohën kur karburanti të dorëzohet në pronësi të AK (karburanti konsiderohet i dorëzuar në pronësi të AK sipas kushteve të përcaktuar në Aneksin 1 Specifikimet teknike të detyrueshme, pra ku kemi dallimin në mes dorëzimit në rezervarët e menaxhuar nga AK dhe rezervarët që do të jepen në menaxhim Furnizuesit.) Paketimin dhe shënimi: Paketimi dhe shënimi duhet të jetë në përputhje me procedurat dhe standardet e aplikuara në industrinë e naftës. Vendndodhja e pikave të karburantit:

		Vendndodhja e pikave te karburantit janë kazermat e FSK-së sipas Aneksit 1 – hapja e ndonjë kazermë të re nga FSK gjatë implementimit të kësaj kontrate do të bëhet pikë për furnizim me karburante në këtë kontratë. Liferimi i karburanteve në pikat e karburanteve: Sipas Aneksit 1 Specifikimet teknike të detyrueshme Dorëzimi i karburantit: Sipas Aneksit 1 Specifikimet teknike të detyrueshme Anulimi i porosisë së dorëzimit: Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë apo anulojë urdhrin për furnizim të karburanteve me një njoftim paraprak me shkrim më së voni 24 orë para kohës së liferimit të porositur.	
Operacionet verifikimit	e	20	Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet Autoritetit Kontraktues – MM/FSK.
		20.1	Në rastet kur kërkohet testimi furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara. Inspektimet dhe testet do të realizohen në mostrat të cilat do të merren nga furnizimet para shprazjes në rezervuarët e AK-se apo në pikat e dorëzimit të kontraktuesit, mostrat duhet te merren në praninë e zyrtarëve përgjegjësi të AK-MM/FSK dhe kontraktuesit.
Pranimi përkohshëm	i	21	Për furnizim me karburante Autoritet Kontraktues –MM/FSK nuk lëshojnë ndonjë pranim te përkohshëm.
Obligimet garancionit	e	22.1	Furnizuesi garanton që furnizimet janë në pajtueshmëri të plotë me specifikimet e kërkuara dhe me udhëzuesit/vendimet e organeve kompetente që janë në fuqi. Furnizuesi garanton që furnizimet nuk kanë asnjë defekt sasior apo cilësor dhe se në rast të konstatimit të këtyre defekteve, Furnizuesi do te bëjë zëvendësimin e menjëhershëm te karburanteve te liferuara dhe për sasinë për të cilën janë konstatuar defektet do të njoftohen organet kompetente dhe do të veprohet sipas kërkesave të tyre. Ne rast te defekteve apo mosfunksionimit normal te pajisjeve apo impianteve te Autoritetit Kontraktues, te shkaktuara nga cilësia e dobët e furnizimeve (karburanteve), Furnizuesi është i obliguar që të bëjë kompensimin total të dëmeve te shkaktuara nga cilësia jo adekuate e furnizimeve.
Ndërprerja Kontratës Autoriteti kontraktues	e nga	26	Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore te Prokurimit. Ndërsa të gjitha kërkesat dhe dëshmitë për shkëputjen e kontratës do të përpilohen nga Autoriteti Kontraktues MM-FSK.
Ndërprerja Kontratës Furnizuesi	e nga	27	Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet Autoritetit Kontraktues – MM/FSK.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	e	29.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe që është e mundur të zgjidhen në mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues - AQP-se, të Autoritetit Kontraktues –MM/FSK qe shfrytëzon kontratën dhe personat përgjegjës të Furnizuesit.
Zgjidhja mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	e	30.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

PARATHENIE

Sipas nenit 94 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin. No. 05/L-092, në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

AQP sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, është përgjegjëse për:

- ✓ Zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Autoritete Kontraktuese;
- ✓ Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese, kryen aktivitetet e prokurimit në emër të tyre; dhe
- ✓ Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese, ndihmon në kryerjen e aktivitetëve të prokurimit.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 15/67 të datës 09.03.2022 për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik, miratuar në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. AQP është autorizuar që të fillojë me procedurat qendrore për Furnizim me Karburante në emër të Autoriteteve kontraktuese (shih listën e autoriteteve kontraktuese Aneksin nr. 7)

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me Karburante për Autoritetet Kontraktuese të identifikuara në Aneksin 7.

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me karburante Autoritetet Kontraktuese të identifikuara në Aneksin 7. Furnizuesit do të jenë përgjegjës për menaxhimin e plotë të furnizimit me karburante për Autoritetet Kontraktuese të identifikuara në Aneksin 7, duke përfshirë:

- a) importimin e karburanteve;
- b) shpërndarjen e karburanteve në të gjithë territorin e Kosovës;
- c) shkarkimin e karburantit në automjete, gjeneratorë, rezervarë të nxehjes.

Karburante do të thotë naftë dhe benzinë.

Specifikimi teknik për Naftë për vetura, gjenerator, nxehje dhe mjete tjera levizese dhe për Benzinë duhet të jetë në harmoni me udhëzuesin administrativ (MTI) nr.09/2020 për Kontrollin dhe Cilësinë e Karburanteve të lëngëta të Naftës të aprovuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Çdo ndryshim i ardhshëm i cilësisë së karburanteve me ndonjë Udhëzim nga MTI apo ndonjë Institucion që autorizohet me ligj që ta bëjë këtë, do të jetë obligues për furnizuesin gjatë realizimit të Kontratës. Për çdo liferim të karburanteve që nuk janë në harmoni me udhëzuesin e lartecukur AK duhet të informojë organet kompetente dhe kontraktuesi do të mbajë përgjegjësinë

Furnizimi do të jetë më së shumti për vetura por AK-FSK mund të përdorë edhe për nevoja tjera siç janë nxehja apo gjenerator apo për nevoja tjera.

Sasia e përafërt e karburanteve:

Nr.	Pershkrimi	Njesia matese	Sasia e perafert per 12 muaj
1	Naft	litër	1,065,000
2	Benzin	litër	6,600

Cilësia e karburanteve duhet të jetë në harmoni me udhëzuesin administrativ (MTI) nr.09/2020 për Kontrollin dhe Cilësinë e Karburanteve të lëngëta të Naftës të aprovuar nga Ministria e Tregtisë dhe

Industriisë. Çdo ndryshim i ardhshëm i cilësisë së karburanteve me ndonjë Udhëzim nga MTI apo ndonjë Institucion që autorizohet me ligj që ta bëjë këtë, do të jetë obligues për furnizuesin gjatë realizimit të Kontratës.

Shpërndarja e karburanteve do të bëhet nga kontraktuesi sipas kërkesave nëpër të Gjitha kazermat e FSK-së në territorin e Kosovës si: Prishtinë, Mitrovicë, Istog, Gjiilan, Ferizaj, Pomazotin, Prizren, Gjakovë dhe në ndonjë kazermë tjetër që FSK mund ta merre në posedim gjatë kohës sa zgjatë kontrata, pra FSK rezervon të drejtën të shtoj lokacione të tjera për furnizim me karburante në çfarëdo kohe gjatë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës.

Kontraktuesi do të dorëzohen pompat/aparatet e derivateve, një rezervuar i naftës dhe një benzinës (aty ku posedojnë kazermat) nën menaxhim, OE do të ketë obligim që të ofroj furnizime dhe shërbimet e mbushjes (tankimin) të automjeteve të FSK-së me personel të vetin çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00 si dhe në raste të jashtëzakonshme edhe gjatë ditëve tjera 24/7 në mbikëqyrje nga përgjegjësit e Njësisë të FSK-së në pompa statike, pra Kontraktuesi do të përdor pompat (aparatet).

Pranimi-dorëzimi i pikave të karburanteve neper kazermat e FSK-së do të bëhet nga një komision i caktuar nga secila njësi në bashkëpunim me menaxherin dhe ndihmës menaxherin, sasia e pranuar e derivateve në rezervuar me fillimin e kontratës duhet edhe të dorëzohet nga OE fitues në përmblyllje të kontratës.

Sasia e derivateve në rezervuarët e pompave statike që do të epen nën menaxhim të kontraktuesit në asnjë rast nuk duhet të bje me pak se 30% të kapacitetit të rezervuarit, AK do ta njoftoj OE me shkrim për nevojat e furnizimeve me derivate, porosia për furnizimi me derivate në rezervuarët e pikave të karburanteve nuk do të jetë me e vogël se 5000 litra përveç ndonjë rasti të veçant. Afati për dorëzimin e porosisë nga kontraktuesi do të jetë maksimum 10 ditë kalendarike nga lëshimi i porosisë.

Në rast se automjeti shkon në pikën e karburantit dhe nuk ka karburante, AK do të ketë të drejtë të bëjë një raport të dështimit të liferimit të derivateve (takimit të automjetit) i cili pas verifikimit do të jap të drejtë AK që për çdo mos tankim të automjetit të zbraz/heqë një shumë prej 100 euro nga fatura e ardhshëm e furnizimit dhe të jap kontraktuesit vërejtje për secilin rast.

Mirëmbajtja e Pompave statike do të jetë obligim i kontraktuesit gjatë kohëzgjatjes së kontratës, duke ofruar mirëmbajtjen e tyre dhe funksionalitetin e vazhdueshëm, në raste të defekteve të pompave/aparateve OE fitues rregullimin e tyre duhet ta beje brenda afatit kohor prej 24 orëve, gjithashtu OE fitues se paku një (1) herë në vite me shpenzimet e veta të bëjë verifikimin e mjeteve matës të rrjedhjes (bazhdarimi i aparateve)

Demet e shkaktuara në automjete dhe pajisje nëse janë si pasojë e kualitetit të dobët të derivateve i kompenson OE fitues.

Testimi i cilësisë së karburanteve të bëhet kohë pas kohe minimum dy (2) herë brenda vitit, shpenzime që do të shfaqen gjatë testimit të karburanteve të kompensohen nga kontraktuesi, ndërsa nëse kërkohet analiza të cilësisë me shumë se dy (2) herë shpenzimet të bart pala që është fajtores.

OE fitues në rast krize për karburante duhet të mbajë në rezervat e tij të deklaruar për FSK-në, Naftë (disel)-500,000 litra dhe benzinë 20,000 litra.

Kurdo që bëhet dërgesa e karburantit tek AK (kazermat/njësit e FSK-së) secila dregës (cistern) duhet të jetë e shoqëruar me një Certifikatë të kualitetit të lëshuar nga një Institucion i Pavarur për Certifikim të cilësisë.

Njësoret (instrumenti matës) neper autocisterna te OE fitues që do ta bëj furnizimin duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, pra të gjithë njësoret (instrumentet matëse) në autocisterna duhet të kenë kaluar testin e saktësisë (rrjedhjes dhe vëllimit).

Dokumentet (Dokumentet e Konformitetit) e lëshuara nga prodhuesi ose përpunuesi, me të cilat dëshmohet se karburantet e naftës janë në përputhje me Udhëzuesin Administrativ (MTI) nr.09/2020 për Kontrollin dhe Cilësinë e Karburanteve të lëngëta të Naftës .

Çdo rrezik i humbjes apo dëmtimit të karburanteve nga ndonjë shkak deri në kohën kur karburanti të dorëzohet në pronësi të njërive të FSK-së do të jetë përgjegjësi e OE.

Specifikimi teknik për Diesel 10 ppm për vetura, gjenerator, nxehje dhe mjete tjera lëvizëse dhe benzinë 10 ppm (95 dhe 98) duhet të jenë sipas Udhëzuesit Administrativ (MTI) nr.09/2020 për Kontrollin dhe Cilësinë e Karburanteve të lëngëta të Naftës përfshirë edhe vendimin/et.

Pagesa e derivateve në pompat statike do të bëhet në baza mujore sipas konsumit mujor vetëm për derivatet që do të mbushen (tankohen) automjetet, ndërsa për ngrohje dhe gjenerator paguhen derivatet që pranohen nga personeli/komisioni i autorizuar i FSK-së pas zbrazjes nëpër rezervuar.

Kërkohet nga furnizuesi që të marr nënshkrimet e pranimit të karburanteve, të lëshoj kuponin e karburantit apo fletën e të dhënave nga të gjithë personeli i autorizuar i FSK-së dhe MM që marrin karburante për automjete dhe mjete pune.

Çmimet për litër të karburanteve të llogariten sipas çmimit të berzës mujore të Platts-it, çmimi i berzës mujore sigurohet dhe llogaritet nga AK, me se largu deri me datë pesë (5) të muajit vijues për datën që bëhen furnizimet (për datën që do të bëhet kërkesa për zotim të mjeteve dhe urdhër blerja apo për datën që ka bërë furnizimin), dhe dërgon të furnizuesi kalkulimin e çmimit për muajin paraprak.

Aneksi 9 Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve

NR.	Pershkrimi	Diesel	Benzine	Fiks (F) /Varibal (V)
1	Berza mesatare mujore CIF Med (Genova/Lavera Ton/\$	1,143.4348	1,081.5652	V
2	Kursi mesatar mujor \$/euro (variabile)	0.9076	0.9076	V
3	Çmimi i tonit ne Euro (1X2)	1,037.7393	981.5887	V
4	Shëndrrimi i tonit ne litër (fiks)	1,191	1,191	F
				Nje (l)Ton diesel = 1 191 litra
				Nje (l) Ton benzin = 1 368 litra
5	Çmimi për litër ne euro (3/4) (Çmimi para taksave)	0.8713	0.7175	V
6	Akciza për litër (fiks)	0.3600	0.3600	Fiks sipas ATK dhe Doganës, mund të ndyrshoj vetëm nëse ndryshojn tarifat sipas ATK dhe Doganës/Qeveris
7	GJITHSEJ (5+6)	1.2313	1.1025	V
8	Premiumi i kompanisë / litër sipas ofertës dhe kontratës	-	-	F Këtu vendoset Premium/fitimi I OE te kontraktuar referoju shënimit te poshtëshënuar
9	Gjithësejt çmimi me Premium (7+8)	-	-	V

10	TVSH 18% / litër	-	-	Fiks 18% TVSh, kjo mund ndryshoj vetëm nëse ndryshon tarifat sipas ATK/Qeveris
11	Çmimi për litër për faturim (9+10)	-	-	V
	Të dhënat e pasqyruara në tabele janë të marruar nga llogaritja e Çmimit të karburanteve për muajin Mars 2022. Kalkulimi i Çmimit gjatë realizimit të kontratës bëhet duke u bazuar në çmimin mesatar mujor të berzes së Plattit CIF Med (Genova/Lavera), kursit mesatar mujor të Bankes Qendrore Evropiane dhe elementeve tjera fikse dhe variabile që janë pasqyruar në Aneksin 9 - Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve.			
	Shënim: Në nr. rendor 8 OE duhet të vendosin premiumin / fitimin e kompanisë duke llogaritur të gjitha shpenzimet që nuk janë paraparë më lartë në këtë tabelë.			

SQARIM:

1. AQP para publikimit të njoftimit të dhënies së kontratës do të kërkojë një deklaratë me shkrim nga OE se do të mbajnë së paku 10% të sasisë të kontraktura si rezervë për implementimin e kontratës.
2. Nëse ka mospërputhje në mes Njoftimit të Kontratës dhe Dosjes së Tenderit (DT) si pasojë e platformës elektronike (çështjeve teknike) do të vlejë Dosja e Tenderit.

Prokurimi: UA/2016-22-7727-1-1-1

Nr i brendshëm: AQP/22/005-R/111

Tituli: Furnizim me karburante – Niveli Qendror - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së - Ritender

1 Furnizim me karburante – Niveli Qendror - Furnizim me
karburante për nevojat e FSK-së - Ritender

Kodi i tenderit: FSK 15.08.2022

Data: 15.08.2022

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1. Deklarata nen betim.pdf
2.	2. Specifikimet teknike te detyrueshme.pdf
3.	3. Certifikata e regjistrimit te biznesit.pdf
4.	4. Licencat.pdf
5.	5. Lista e mjeteve te transportit.pdf
6.	6. Anex 8.pdf
7.	7. Pasqyrat Financiare.pdf
8.	8. Autorizimi.pdf
9.	9. Sigurimi.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Furnizim me karburante – Niveli Qendror - Furnizim me karburante për nevojat e FSK- së - Ritender	LISTA E ÇMIMEVE.xlsx

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

AUTORITETI KONTRAKTUES

Agjencia Qendrore e Prokurimit , Nderresa e Germis, 10000, Prishtinë,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: UA/2016-22-7727-1-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: "HIB PETROL"SH.P.K., Magjistralla Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol, 10000, Cagllavice, Kosovë

E-mail: tenderat@hibpetrol.com

Personi kontaktues: korab sejdin

Telefoni: 044/668023

Faxi:

Numri fiskal: 600015376

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: UA/2016-22-7727-1-1-1

Titulli i kontratës: Furnizim me karburante – Niveli Qendror - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së - Ritender

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Furnizim me karburante – Niveli Qendror - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së - Ritender

3. Çmimi total i tenderit është:

1 625 530,24 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 120 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

LISTA E ÇMIMEVE

NR.	Pershkrimi	Naft – sipas Aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme	BENZIN – sipas Aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme
1	Berza mesatare mujore CIF Med (Genova/Lavera Ton/\$	1,143.4348	1,081.5652
2	Kursi mesatar mujor \$/euro (variable)	0.9076	0.9076
3	Çmimi i tonit ne Euro (3=1x2)	1,037.7393	981.5887
4	Shndërrimi i tonit ne litër (fiks)	1,191	1,368
5	Çmimi për litër ne euro (5=3/4)	0.8713	0.7175
6	Akciza për litër (fiks)	0.3600	0.3850
7	GJITHSEJ (7=5+6)	1.2313	1.1025
8*	Premiumi i kompanisë për 1 litër *	0.0550	0.0550
9	Gjithsej çmimi me Premium (9=7+8)	1.2863	1.1575
10	TVSH 18% / litër (10=9x18%)	0.2315	0.2084
11	Çmimi për litër për faturim (9+10)	1.5179	1.3659
12	Totali I litrave	1,065,000	6,600
13	Cmimi total I ofertes (13=11x12)	1,616,515.35	9,014.89
	Totali	1625530.24	

Vërejtje/Sqarim: Ofertuesi duhet te plotesoj vetem kolonen 8 dhe cmimi total do te llogaritet sipas formule

- Premiumi për litër lejohet te shënohet me maksimum katër (4) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit te katërt (4) nuk do te merret për bazë në llogaritje të vlerës se ofertës.
- Premiumi për litër do të jetë i pandryshuar gjatë tërë afatit të vlefshmërisë se kontratës dhe do te llogaritet sipas premieumeve te dhëna nga Operatori Ekonomik për llojet e karburanteve ne Pjesa LISTA E ÇMIMEVE - kolona – 8
- Çmimet për faturim te KARBURANTEVE do te llogariten nga Agjencia Qendrore e Prokurimit ne baza mujore dhe do te formohen sipas te dhënave te pasqyruara në Tabelë që është formuar sipas Aneksit 10 te dosjes së
- Bazë për vendosjen e vlerave në tabelë është çmimi sipas berzës (formulës) të Muajit Mars 2022 (duke rrumbullaksuar vlerat me 4 numra pas presës dhjetore

Identifikimi i operatorit ekonomik (OE)	
Emri i OE:	HIB Petrol
Emri dhe mbiemri i perfaqesuesit te OE:	Korab Sejdiu
Nenshkrimi:	
Data:	8/15/2022
Vula:	



HIB PETROL

Për: Agjencia Qendrore e Prokurimit

Titulli: Furnizim me karburante – Niveli Qendror - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së – Ritender

Tema: Vendim per caktimin e menaxherit te kontrates

Vendim

HIB Petrol merr vendim qe per kontraten: "Furnizim me karburante – Niveli Qendror - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së – Ritender", te caktojë menaxher kontrate Korab Sejdiu

Emri	Korab Sejdiu
Pozicioni	Menaxher i Kontraktimeve
Data	24.08.2022
Nenshkrimi	
Vula	



Pjesë përbërëse e policës: 038957

Për: AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: HIB PETROL SHPK, Talinovc i Muhaxherëve, Magj. Ferizaj-Prishtinë
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE:

Titulli i aktivitetit të prokurimit: FURNIZIM ME KARBURANTE -NIVELI QENDROR-FURNIZIM ME
KARBURANTE PER NEVOJAT E FSK-SE RITENDER
Numri i prokurimit: UA/2016-22-7727-111

SIGURIA E KONTRATËS

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para Jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **162,553.02 EURO (NJEQIND E GJASHTEDHJET E DY MIJE E PESEQIND E PESEDHJET E TRI EURO E DY CENT)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **162,553.02 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen prej **29-08-2022 00:00:00** deri **29-09-2023 23:59:59**

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:

SCARDIAN Sigurime

Rr. Perandori Justinian Nr.3

10000 Prishtinë

Kosovë

2022-08-24 13:38:32





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810662834

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Hib Petrol SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:

Magj. Ferizaj-Prishtinë
Talinovc i Muhaxherëve
Ferizaj

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

30/03/2005

25/02/2019

Data / Date / Datum



W. Telum

Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: **10002098**